



Me. 50 prot  
Shkodër 20/06/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 16 Datë 13.06.2018

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “RO-GENT-1” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim ne parim) te subjektit “RO-GENT-1” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Keshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “RO-GENT-1” SH.P.K me administrator Z. Arben ÇUPI, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Zallit te Bulqizës**, degë e Lumit Drini i Zi për prodhim energjie elektrike në fshatin Fushë Bulqizë, Njësia Administrative Fushë Bulqizë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC ARAS-M do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 44 38 210 ; Y - 45 98 135 ; Z - + 718 m

Koordinatat e godinës së centralit: X - 44 39 130 ; Y - 45 98 800 ; Z - + 670 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 44 39 150 ; Y - 45 98 640 ; Z - + 670 m

Prurja mesatare e përroit: Q mes = 1.286 m<sup>3</sup>/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 2.000 m<sup>3</sup>/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol = 0.257 m<sup>3</sup>/sek;

Prurja që shkarkohet: Q = 2.000 m<sup>3</sup>/sek.

2- Autorizimi(miratimi ne parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

SEKRETAR

**Raimonda GURI**



KRYETAR

**Cesk MULLJA**

